



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:131746

Datë: 21.07.2021

Numri i dokumentit: 02012791

PPP.nr.29/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore, me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, në çështjen juridike të kreditorit Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë Magjistratja Prishtinë Fushë Kosovë, përfaqësuar nga drejtori S. M., kundër debitorit I. A. me adresë në fsh. S. Komuna e Istogut, për shkak të borxhit në shumë prej 8,380.00 €, pas prapësimit të ushtruar nga debitori me dt: 03.06.2021, kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr. 872/2021 të dt.26.05.2021, jashtë seance me dt.21.07.2021 nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET prapësimi i debitorit I. A. me adresë në fsh. S. Komuna e Istogut, ushtruar kundër urdhrit mbi lejimin e përmbarimit P.nr. 872/2021 të dt.26.05.2021, si dhe **SHFUQIZOHET** urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr. 872/2021 të dt.26.05.2021, dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore abrogohen.

A r s y e t i m

Kreditori, Byroja Kosovare e Sigurimeve me seli në Prishtinë Magjistratja Prishtinë Fushë Kosovë, përfaqësuar nga drejtori S. M. ka ushtruar propozim për përmbarim, duke kërkuar që të lejohet përmbarimi dhe të obligohet debitori pagesën e borxhit në shumë prej 8,380.00 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, të gjitha në afat 7 ditor nga dita e pranimit të propozimit si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, në të kundërtën të bllokohet të gjitha llogarit bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjetet monetare në llogari të behet sekuestrimi, regjistrimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme dhe mjetet e mbledhura të barten në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuar në propozimin për përmbarim të datës 25.05.2021.

Përmbaruesi privat, me urdhrin P.nr. 872/2021 të dt.26.05.2021 e ka lejuar përmbarimin sipas propozimit të kreditorit në këtë çështje përmbarimore.

Debitori, debitorit I. A. me adresë në fsh. S. Komuna e Istogut, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim kundër urdhrin përmbarimor, duke i propozuar gjykatës që të nijetin urdhër ta anuloj dhe të përfundohet procedura përmbarimore duke anuluar veprimet e ndërmarra nga përmbaruesi, me arsyetimin se urdhri me të cilin është lejuar përmbarimi, është në kundërshtim me dispozitat e nenit 71 pika 1, 1.1 dhe 1.2 të LPP-së e në lidhje me nenin 391 par.1 pika c, pasi që me të njëjtin vendim kërkesë padi a e paditëses tani kreditorit është hedhur poshtë si çështje e gjykuar, po ashtu ka kaluar afati që sipas ligjit të mund të kërkohej përmbarimi sipas dispozitës së nenit 71 par.1 nen par.1.4 të LPP-së

Pas ngritjes së prapësimit nga debitori, me të njëjtin është njoftuar kreditori, ku me dt. 08.06.2021 ka ushtruar përgjigje në prapësim me propozim që të refuzohet në tersi prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor me arsyetimin se pretendimet e debitorit janë tërësisht të pa argumentuara, kontradiktore dhe në kundërshtim me nenin 71 të LPP-së, për faktin se me asnjë provë nuk i ka argumentuar pretendimet e tij të cilat do të ndikojnë në mos ekzekutimin e shumave të kredive, po ashtu kreditori ka bërë përpjekje të vazhdueshme për realizimin e kredisë në atë mënyrë që të ju ik shpenzimeve të procedurës mirëpo një përpjekje e tillë ka qenë e pa efektshme dhe ka ndikuar në prolongim të procedurës.

Gjykata Themelore në Pejë- Dega Istog, si përmbarimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i bazuar. Arsyet e paraqitura në prapësim të debitorit tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarimi i lejuar me urdhër përmbarimor.

Gjykata, pas shqyrtimit të provave në shkresat e lëndës, si dhe lidhur me pretendimet e debitorit në prapësimin kur thirret në atë se lejimi i përmbarimit është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenin 71 par.1, 1.1 dhe 1.2 e në lidhje me nenin 391 par.1 pika c, pretendimet e lartcekura gjykata i aprovoj pjesërisht si të bazuar dhe atë duke u bazuar në shkresat e lëndës, ku shihet se aktvendimi me të cilin është lejuar përmbarimi është i pa përshtatshëm për përmbarim, për faktin se me të njëjtin padia e paditësit që tani është në cilësi të kreditorit është hedhur poshtë, dhe me asnjë pikë të vetme të të njëjtit vendim nuk është obliguar i padituri që tani është në cilësi të debitorit pagesa e shumës të cilën e kërkon kreditori në propozim për përmbarim, andaj duke u bazuar në nenin 24 të LPP-së i cili nën flet për përmbarueshmërin e vendimit, ku në par.1 të po të njëjtit nën parashihet se “ Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbarimi e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i

përmbarueshëm po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po që se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”, e ne rastin konkret propozimi për përmbarim është lejuar pa u përmbushur kushtet ligjore gjegjësisht ne bazë të një vendimi me të cilin asnjë herë nuk është urdhëruar debitori që ta përmbush kredinë, që tani kreditori e kërkon ne procedurë përmbarimore, andaj vendosi si ne dispozitiv të këtij aktvendimi duke e aprovuar prapësimin e debitorit dhe duke shfuqizuar urdhrin dhe të gjitha veprimet e ndërmarra përmbarimore.

Gjykata me rastin e vendosjes pati parasysh edhe pretendimet kreditorit të dhëna ne përgjigje ne prapsim, mirëpo të njëjtat nuk ishin me rëndësi që të vendosej ndryshe, andaj i refuzoj si të pabazuara.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, konform dispozitave të nenit 3, 21, 22 par.1.1, 24 par.1, 38, 69, 71 e 73 par. 3, të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, gjykata vendosi si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.29/2021 dt.21.07.2021

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, ne afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.